

VENDIM
Nr. 520, datë 13.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 19.3.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE DHE TË UDHËTARËVE, SI DHE PËR NJOHJEN E DOKUMENTEVE ZYRTARE, TË CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË", TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 43, të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe neneve 83 e 87, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren që i bashkëlidhet vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

I. Në kapitullin II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "b", në pikën 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

"b) të ketë qëndrueshmërinë e duhur financiare;"

2. Pas shkronjës "c", në pikën 1, shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) të ketë vendosje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri."

3. Shkronja "c", në pikën 2.2, riformulohet si më poshtë vijon:

"c) me aftësinë e tij si drejtues veprimtarie, personi i përmendur sipas shkronjës "a" të kësaj pike, lejohet të drejtojë veprimtarinë e transportit deri në 3 (tri) ndërmarrje të ndryshme, me një numër të përgjithshëm maksimal të mjeteve motorike dhe/ose kombinimit të mjeteve, prej 36 mjeteve."

4. Pika 2.3 riformulohet si më poshtë vijon:

"2.3 Drejtuesi i veprimtarisë, i caktuar në përputhje me pikën 2.1 të këtij kapitulli, mund të caktohet në përputhje me shkronjën "c", të pikës 2.2, të këtij kapitulli, edhe në një ndërmarrje ose filial tjetër, përveç asaj të përmendur në pikën 2.1, të këtij kapitulli, veprimtaritë e të cilave kryhen me një numër të përgjithshëm maksimal të mjeteve motorike dhe/ose kombinimit të mjeteve, prej 30 mjeteve."

5. Pas pikës 3.5 shtohet pika 3.5.1, me këtë përmbajtje:

"3.5.1 Operatori i transportit informon me shkrim organin e transportit të lëshimit të licencës për ndonjë dënim të vendosur ndaj tij ose të ndonjë personi të përmendur në pikën 2.1 dhe në shkronjën "a", të pikës 2.2, të këtij kapitulli, brenda 28 ditëve, nga dita që ka marrë dënimin ose nga dita që e ka apeluar dënimin."

6. Shkronja "a", në pikën 4.1, riformulohet si më poshtë vijon:

"a) 2-vjeçare, për shkelje të nënpikave të shkronjës "a", të pikës 3.1, me përjashtim të nënpikave "xi" dhe "xv";"

7. Titulli i pikës 5 riformulohet si më poshtë vijon:

"5. Plotësimi i kushtit për qëndrueshmërinë e duhur financiare"

8. Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5.2, riformulohen me këtë përmbajtje:

"a) 7 200 euro, për mjetin e parë, dhe 4 000 euro për çdo mjet shtesë, të autorizuar për t'u

¹ Ky vendim është i përafëruar me rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, "Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE", nr. CELEX 32009R1071, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian L300, 14.11.2009, faqe 51–71.

përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;

b) 140 000 lekë, për mjetin e parë, dhe 70 000 lekë për çdo mjet shtesë, të përdorur kur kryen transport të mallrave e të udhëtarëve brenda vendit.”.

9. Pika 5.4 riformulohet me këtë përmbajtje:

“5.4 Kushti, në lidhje me kapitalin minimal të vlefshëm dhe rezervë të qëndrueshmërisë financiare, të veprimtarisë së ndërmarrjes në transportin rrugor ndërkombëtar dhe brenda vendit të mallrave dhe udhëtarëve, i përcaktuar sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5.2, do të arrihet një vit nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.”.

10. Pika 6.4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“6.4 Kualifikimi dhe trajnimi periodik i kandidatëve që kërkojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale (CKP) për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor zhvillohet në qendrat e trajnimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin.

6.4.1 Qendër trajnimi nënkupton një person, entitet ose organizatë, e miratuar për zhvillimin e kurseve të trajnimit profesional të kandidatëve që dëshirojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale për drejtues veprimtarie në transportin rrugor dhe në përputhje me kërkesat e rregulloreve evropiane përkatëse, organizmave ndërkombëtare të transportit, si dhe kërkesat e legjislacionit shqiptar.

6.4.2 Kushtet bazë të pranimit si qendër trajnimi janë:

a) Reputacioni i mirë i drejtuesit të veprimtarisë së qendrës, drejtuesve të programeve dhe instruktorëve, sipas pikës 3, të kapitullit II, të kësaj rregulloreje;

b) Plotësimi i kushteve të mjaftueshme për mjedisin, infrastrukturën dhe bazën didaktike;

c) Kompetenca profesionale e stafit të qendrës së trajnimit, në përputhje me programin e trajnimit;

ç) Programet e trajnimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin.

6.4.3 Kriteret që duhet të përmbushë qendra e trajnimit, kërkesat që duhet të plotësojnë instruktorët e trajnimit si dhe verifikimi në vazhdimësi i përmbushjes së këtyre kriterëve nga qendra e trajnimit, e miratuar, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

6.4.4 Modeli i certifikatës së kompetencës profesionale (CKP) për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor miratohet nga ministri përgjegjës për transportin, në përputhje me rregulloren evropiane përkatëse dhe organizmat ndërkombëtare, ku bën pjesë Republika e Shqipërisë.”.

11. Pika 6.5 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6.5 Me qëllim përditësimin e njohurive në fushën e transportit, drejtuesit e veprimtarisë kryejnë trajnimin e reduktuar, pasi janë plotësuar 5 vjet nga lëshimi i certifikatës së kompetencës profesionale që ata zotërojnë.

6.5.1 Qendra e trajnimit e autorizuar harton programe të veçanta për trajnimin e reduktuar, që burojnë nga programi bazë. Kandidati duhet të aplikojë, të paktën, 2 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës. Tarifat për trajnim caktohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit të Financave.”.

12. Pika 7.2 riformulohet si më poshtë vijon:

“7.2 Komisioni i vlerësimit të provimit, sipas pikës 7.1, emërohet nga ministri përgjegjës për transportin dhe përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Kryetari dhe anëtarët e komisionit duhet të jenë persona me integritet të lartë moral e profesional në fushën e transportit. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pajisur me diploma të shkollave të larta, të përmendura në pikën 8.1 të këtij kapitulli.”.

13. Pika 7.3 shfuqizohet.

14. Pika 7.4 riformulohet si më poshtë vijon:

“Provimi i kandidatëve zhvillohet në një nga ambientet e qendrave të trajnimit, të miratuara.”.

15. Pika 8.4 riformulohet si më poshtë vijon:

“8.4 Organet e transportit dhe ose QKL-ja do të pranojnë si provë të mjaftueshme të kompetencës profesionale një certifikatë që përputhet me certifikatën model, të përcaktuar në

shtojcën III, të rregullores evropiane 1071/2009, dhe që lëshohet nga autoriteti ose organi i autorizuar për këtë qëllim nga shteti anëtar i BE-së.”.

16. Pas pikës 8 shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Kushtet në lidhje me kërkesën e vendosjes.

Për plotësimin e kërkesave të shkronjës “d”, të pikës 1, ndërmarrja e transportit duhet:

a) të jetë e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, me ambiente në të cilat ajo mban dokumentet kryesore të biznesit, në veçanti dokumentet e kontabilitetit, të personelit, dokumentet që përmbajnë të dhëna në lidhje me orët e drejtuesve të mjeteve dhe ndonjë dokument tjetër, tek i cili autoriteti përgjegjës duhet të ketë akses, me qëllim verifikimin e përputhjes me kushtet e vendosura në këtë rregullore;

b) pas marrjes së licencës, të ketë në dispozicion të saj një ose më shumë mjete rrugore të vëna në qarkullim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të regjistruara, qofshin në pronësi, me kontrata blerjeje me këste ose me qira;

c) të drejtojë efektivisht dhe në vazhdimësi, me pajisje administrative të nevojshme, operationet e saj në lidhje me mjetet e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, në një qendër operative të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

II. Në kapitullin IV bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.1 e këtij kapitulli, riformulohet si më poshtë vijon:

“1.1 Në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, krijohet regjistri elektronik kombëtar për ndërmarrjet e transportit rrugor. Regjistri përmban të dhënat lidhur me drejtuesit e veprimtarisë së transportit, drejtuesit e mjeteve, licencat dhe dokumentet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për të gjithë operatorët e transportit rrugor.”.

2. Pika 1.2 riformulohet si më poshtë vijon:

“1.2 Regjistri elektronik kombëtar vendoset në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat që përmban regjistri elektronik kombëtar trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës, të caktuar për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Pika 1.3 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“1.3 Të gjitha ndërmarrjet e transportit rrugor, të vendosura në Shqipëri, janë të detyruara të regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor.

Pas licencimit të subjektit transportues, organi që e ka licencuar atë dërgon informacion të mbajtësi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor për ndërmarrjen e transportit dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.”.

4. Pika 1.6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1.6. Të dhënat në lidhje me një ndërmarrje, së cilës i është pezulluar ose i është hequr licenca apo kur drejtuesi i veprimtarisë është deklaruar i papërshtatshëm, do të mbahen në regjistër për një periudhë dyvjeçare, nga data e pezullimit ose e heqjes së licencës, dhe më pas do të fshihen menjëherë. Të dhënat duhet të shoqërohen në regjistër me arsyet e heqjes së licencës ose deklarimin e papërshtatshmërisë së drejtuesit të veprimtarisë.”.

5. Pika 1.8 riformulohet si më poshtë vijon:

“1.8 Ministria përgjegjëse për transportin të marrë masat për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar deri më 1 janar 2017.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi